



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sport
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr.47/2024
Datë: 08.04.2024

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës në mbështetje të neneve 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura, bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1) të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor, Rregulloren NR. 11/2022 Për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi me numër të protokollit 1889/2024 i datës 05.04.2024 i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave - propozimeve të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturore.
2. Lista e aprovuar si në pikën një (1) të këtij Vendimi, përfshin 7 (shtatë) asete të trashëgimisë kulturore si në vijim:
 1. Kulla e Qelisë, Qeli;
 2. Kalaja e Madhe e Qelisë, Qeli;
 3. Shpella e Shën Helenës, Qeli;
 4. Shpella e Zezë në Belle, Belle e Poshtme;
 5. Kulla e Nekë Halilit (Lilaj), Fshati Belle;
 6. Ujëvara në Belle;
 7. Shtegu i Mijëvjeçarit.

3. Obligohet QRTK Pejë që asetet sipas pikës 1 të dispozitivitetit të këtij vendimi t'i regjistrojë në databazë, t'iu jep numrin unik, t'i kategorizojë sipas Ligjit në fuqi dhe t'i përfshijë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme, në kategorinë përkatëse.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

QRTK - Pejë e ka përgatitur propozimin dhe formularin e inventarizimit, të cilin më pas e ka dërguar në Komisionin Profesional Shqyrtues të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve - IKMM si institucion kompetent për kategorinë arkitekturale si dhe në Institutin Arkeologjik të Kosovës - IAK si institucion kompetent për kategorinë arkeologjike. Këto institucione pas shqyrtimit i kanë sjellë rekomandimet për aprovim për kategorizimin e këtyre aseteve në kategorinë e Trashëgimisë Kulturore Arkitekturale, Arkeologjike dhe Peizazhe Kulturore.

KPSH - IAK e ka dhënë rekomandimin që **Kulla e Qelisë, Qeli; Kalaja e Madhe e Qelisë, Qeli; Shpella e Shën Helenës, Qeli; Shpella e Zezë në Belle, Belle e Poshtme** të përfshihen në listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme në kuadër të kategorisë Trashëgimi Arkeologjike, Nënkatëoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat. KPSH – IKMM ka dhënë rekomandimin që **Kulla e Nekë Halilit (Lilaj), Fshati Belle** të përfshihet në listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme në kuadër të kategorisë Trashëgimi Arkitekturore, Nënkatëoria: Monument / Ansambël, ndërsa **Ujëvara në Belle dhe Shtegu i Mijëvjeçarit** në kategorinë Peizazh Kulturor.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga QRTK Pejë, si dhe rekomandimit të KPSH –IAK, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme "**Kulla e Qelisë, Qeli** " për arsye se i përmban këto vlera:

- Vlerat historike: Kulla e Qelisë, Qeli, në Belle ka vlerë të madhe historike për shkak se ka qenë një kompleks me një shtrirje të madhe, i përbërë nga tri objekte, të emëruara si: objekti 1, 2 dhe 3, objekte që kanë shërbyer për predikuesit e fesë së krishterë gjatë periudhës mejetare.
- Vlerat Estetike / artistike: Kulla e Qelisë, Qeli ka po ashtu vlera artistike si në aspektin e jashtëm, por në veçanti në atë të brendshëm, tek të tri objektet të cilat për nga aspekti artistik paraqesin vlera unike. Dy nga tri objektet ishin të dekoruara me afreska të cilat janë të pranishme edhe sot, pra tek objekti 1 dhe 3, pasqyrohen vlera të veçanta estetiko-artistike, të realizuara mjeshtërisht me ngjyra të ndryshme.
- Vlerat shoqërore: Krahas vlerave të mësipërme, Kulla e Qelisë, Qeli, ka edhe vlera të rëndësishme shoqërore, sepse dëshmon për të kaluarën që ishte një vend i banuar religjioz, ndërsa sot ngjitur me Kullën e Qelisë kalon shtegu i rrugës "Via Ferrata", ku nga mbarë bota vijnë turistë të shumtë për të kaluar këtë shteg. Kjo hapësirë është po ashtu pjesë e një peizazhi të pasur kulturor me një shtrirje horizontale përgjatë shtratit të Lumbardhit të Deçanit. Këto vlera të trashëguara përfaqësojnë interes të gjerë shoqëror.
- Vlerat Shkencore / Edukative: Kulla e Qelisë, Qeli, paraqet vlera të jashtëzakonshme shkencore, sepse në territorin e Kosovës kemi vetëm disa të tilla e që studimi i tyre do i

shtonte edhe me shumë vlerat shkencore, për të kuptuar së pari organizimin dhe funksionimin e tyre gjatë periudhës mesjetare.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK - së pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga QRTK Pejë, si dhe rekomandimit të KPSH –IAK, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme "**Kalaja e Madhe e Qelisë, Qeli**" për arsye se i përmban këto vlera:

- Vlerat historike: Kalaja e Madhe e Qelisë, Qeli, ka vlera arkitekturale, arkeologjike e po ashtu historike. Kjo kala, bazuar në të dhënat përnjohëse, i takon Kalave të Antikitetit të Vonë të tipit ushtarak.
- Vlerat Estetike / artistike: Kalaja e Madhe e Qelisë, ka vlera estetike/artistike, kjo bazuar në arkitekturën e ndërtimit të mureve dhe të harmonizimit të saj me konfiguracionin e terrenit dhe peizazhin natyror.
- Vlerat shoqërore: Kalaja e Madhe e Qelisë, është ndërtuar në një shkëmb masiv, shkëmb në të cilin sot kalon shtegu për ngjitje "Via Ferrata". Për t'u ngjitur në këtë shteg me patjetër duhet kaluar nëpërmes kalasë, ku edhe ruhen struktura të shumta arkitekturore-muret e kalasë, të cilët e bëjnë këtë aktivitet edhe më atraktiv dhe impresionues për turistët vendorë dhe ata ndërkombëtarë. Ndër tjerash, nga pjesa e sipërme e kalasë duket një peizazh i mrekullueshëm në drejtim të Manastirit dhe qytetit të Deçanit.
- Vlerat Shkencore / Edukative: Kalaja e Madhe e Qelisë, është një lokalitet arkeologjik i cili deri më sot nuk është hulumtuar. Duke qenë pjesë e sistemit fortifikues të Antikitetit të Vonë në territorin e Dardanisë, me zhvillimin e hulumtimeve në këtë kala do të arrihej të kuptohet organizimi dhe funksioni i saj e cila do të shërbente në aspektin shkencor për qartësimin e zhvillimit dhe të organizimit ushtarak gjatë kësaj periudhe.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga QRTK Pejë, si dhe rekomandimit të KPSH –IAK, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme "**Shpella e Shën Helenës, Qeli**" për arsye se i përmban këto vlera:

- Vlerat historike: "Shpella e Shën Helenës" është shpellë natyrore e përdorur si një objekt kulti, që është e krahasueshme me shumë shpella tjera thuajse të njëjta, si ne zonën e Prizrenit dhe të Suharekës, por edhe më gjerë. Ajo paraqet një monument të rëndësishëm për studimet mesjetare të botës religjioze dhe socio - ekonomike, e cila më shumë mundësi u përdor si fjalë asketike, pas pushtimeve Osmane në Ballkan.
- Vlerat Estetike / artistike: "Shpella e Shën Helenës" ka po ashtu vlera estetike / artistike kjo për shkak të gërshëtimit të elementeve natyrore dhe atyre arkitekturore, e po ashtu të afreskave.
- Vlerat shoqërore: Shpella e Shën Helenës ka vlera shoqërore, sepse kjo shpellë paraqet vazhdimësinë e predikimit fetar në periudha të ndryshme e sidomos të asaj mesjetare, por edhe asaj pas pushtimit Osman. Nga pjesa e shpellës shihet një hapësirë mjaft e madhe, duke krijuar pamje të një peizazhi të pasur kulturor.
- Vlerat Shkencore / Edukative: Shpella e Shën Helenës, paraqet po ashtu vlera shkencore, për arsye se mundëson studimin në menyrë të detajuar, jetesën asketike të botës religjioze të kohës, po ashtu edhe studimin e afreskave ekzistuese brenda saj.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga QRTK Pejë, si dhe rekomandimit të KPSH –IAK, e rekomandon për përfshirje në

listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme **"Shpella e Zezë në Belle, Belle e Poshtme"** për arsye se i përmban këto vlera:

- Vlerat historike: "Shpella e Zezë" është shpellë natyrore e përdorur si një objekt kulti, gjatë periudhës mesjetare, e cila si shumë shpella të tjera të njëjta si shpella e lartpërmendur e "Shën Helenës", dhe ato që ndodhen në zonën e Prizrenit dhe të Suharekës është përdorur si faltore. Shpella paraqet një monument të rëndësishëm për studimet e periudhës mesjetare të botës religjioze dhe socio-ekonomike, e cila më shumë mundësi u përdor si faltore asketike, pas pushtimeve Osmane në Ballkan njëjtë sikurse "Shpella e Shën Helenës".
- Vlerat Estetike / artistike: "Shpella e Zezë" ka po ashtu vlera estetike / artistike kjo për shkak të gërshëtimit të elementeve natyrore dhe atyre arkitekturore, e po ashtu të afreskave të ruajtura pjesërisht.
- Vlerat shoqërore: "Shpella e Zezë" ka vlera shoqërore, sepse kjo shpellë paraqet ndikimin fetar në periudha të ndryshme e sidomos të asaj mesjetare, por edhe asaj pas pushtimit Osman. Nga pjesa e shpellës shihet një hapësirë mjaft e madhe, duke krijuar pamje të një peizazhi të pasur kulturor.
- Vlerat Shkencore / Edukative: "Shpella e Zezë" paraqet po ashtu vlera shkencore, sikurse edhe shpellat e tjera, për arsye se mundëson studimin në menyrë të detajuar, jetesën asketike të botës religjioze të kohës, po ashtu edhe studimin e afreskave ekzistuese brenda saj që kanë një karakteristikë të veçantë, ku paraqiten shenjtorët e krishterimit.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga QRTK Pejë, si dhe rekomandimit të KPSH –IKMM, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme **"Kulla e Nekë Halilit (Lilaj), Fshati Belle"** për arsye se i përmban këto vlera:

- "Kulla e Nekë Halilit" përkundër kohës edhe sot ruan elemente karakteristike të teknikës së punimit të gurëgdhendjes dhe përdorimit të gurit të bardhë të gdhendur në qoshtet dhe hapjet e kullës si te dera po ashtu edhe te dritaret.
- Referuar Formularit të inventarizimit nga QRTK – Pejë, Kulla e Nekë Halilit (Lulaj), posedon Vlera arkitektonike, Vlera Historike; Vlerat Shoqërore / Kulturore; Vlera Estetike, Vlera Shkencore / Edukative dhe Vlerat Ekonomike.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga QRTK Pejë, si dhe rekomandimit të KPSH –IKMM, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme **"Ujëvara në Belle"** për arsye se i përmban këto vlera:

- Ujëvara në fshatin Belle bënë pjesë në tërësinë e peizazhit të pasur kulturor të asaj ane. Ky aset i peizazhit kulturor për shkak të ndarjes së përbashkët të parcelës me Kalanë e Belles, konsiderohet vlerë e shtuar për Ujëvarën në Belle.
- Referuar Formularit të inventarizimit nga QRTK Pejë, Ujëvara në Belle, posedon Vlera Historike; Vlerat Shoqërore / Kulturore; Vlerat Estetike; Vlerat Shkencore / Edukative dhe Vlerat Ekonomike.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga QRTK Pejë, si dhe rekomandimit të KPSH –IKMM, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme **"Shtegu i Mijëvjeçarit"** për arsye se i përmban këto vlera:

- Shtegu i Mijëvjeçarit si shteg natyror, shteg i cili që nga ekzistenca e tij e hershme, edhe sot e kësaj dite ka ruajtur gjurmët e shtegimit të tij fillestar në një gjatësi prej rreth 9 km. Ky shteg si i tillë, në emërtim përgatit çdo vizitor se rrugëtimi i tij përgjatë këtij shtegu përmbanë shumë struktura, ndërtime, peizazhe kulturore të periudhave të ndryshme historike, një narrativë që përmbledhë si shtresëzime historike nga shekulli III e deri më sot, duke përmbajtur Vlera Historike; Vlera Shoqërore / Kulturore; Vlera Estetike; Vlera Shkencore / Edukative; Vlera Ekonomike.
- Shtegu i Mijëvjeçarit brenda tij përmbanë Kullën e Qelisë, Kalajnë e Madhe të Qelisë, Shpellën e Shën Helenës, Shpellën e Zezë në Belle, Kullën e Nekë Halilit (Lulaj), Ujëvarën në Belle, Kalanë e Vogël në Belle, si dhe Tumën e vetmuar në Isniq tanimë të mbrojtur.

Vendimi i dërgohet:

Kabinetit të Ministrisë;

Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm

Komisionit Shqyrtues;

Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;

QRTK- Pejë;

Departamentit Ligjor;

Arkivit të MKRS- së

